



Politika e pjtueshmërisë për partnerët globalë

Versioni 1
2016

Politika e pajtueshmërisë për partnerët globalë

Qëllimi i politikës. Agjentët e MoneyGram-it¹ dhe kanale të tjera shpërndarëse jo agente² janë partnerë të rëndësishëm në ofrimin e transferimit të parave nëpërmjet MoneyGram-it si dhe shërbimeve e produkteve të tjera për konsumatorët tanë me vlerë. Për shkak se MoneyGram-it dhe partnerëve të tij u kërkohet që të veprojnë në përputhje me ligje dhe rregulla të ndryshme qeveritare në të gjithë botën, MoneyGram-i ka nxjerrë këtë "*Politikë pajtueshmërie për partnerët globalë*" ("Politika").

Agjentët dhe punonjësit e tyre janë pjesë e frontit të parë të mbrojtjes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit kriminal të produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it. Politika specifikon përgjegjësitë e agentëve globalisht për të vepruar në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse, politikat dhe procedurat e MoneyGram-it dhe veprimet e duhura për zbatimin me efektivitet të standardeve të rrepta kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave.

Kjo politikë përforcon gjithashtu përkushtimin e MoneyGram-it për mbrojtjen e konsumatorëve të tij dhe parandalimin e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve të tij nga kushdo për qëllime mashtruese, pastrim parash, financim të terrorizmit ose aktivitete të tjera të paligjshme. MoneyGram-i kërkon të njëjtin përkushtim nga agjentët e tij dhe pronarët, aksionarët, autoritetet qeverisëse, drejtuesit dhe punonjësit e tyre. Agjentët kanë përgjegjësinë që ta zbatojnë këtë politikë. Për ta vënë në zbatim këtë politikë, MoneyGram-i ka përfshirë këtu kërkesat themelore që qeverisin marrëdhënien midis MoneyGram-it dhe agentëve të tij.

MoneyGram-i vazhdon të përditësojë programet e tij të pajtueshmërisë kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave ("programet") për të rishikuar dhe për t'iu përgjigjur çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj politike. MoneyGram-i i inkurajon agjentët e tij që të kontaktojnë nëpunësin rajonal të pajtueshmërisë të MoneyGram-it ose kontakt tjetër të pajtueshmërisë që i është caktuar agjentit në lidhje me pyetjet për këtë politikë.

1 VEPRIMI NË MËNYRË ETIKE DHE TË LIGJSHME

Detyra gjithëpërfshirëse e agentëve dhe punonjësve të tyre është që të veprojnë në mënyrë etike dhe të ligjshme. Kjo përfshin jo vetëm pajtueshmërinë e plotë të agjentit me ligjet dhe rregullat përkatëse, por edhe besimin se partnerët e MoneyGram-it do të sillen me ndershmëri dhe integritet ndërsa u ofrojnë konsumatorëve produktet dhe shërbimet e MoneyGram-it. Reputacioni i agentëve dhe punonjësve të tyre reflekton në mënyrë direkte vetë reputacionin e

¹ Përkufizimi "agjent" përfshin cilëndo palë që futet në marrëdhënie kontraktore me MoneyGram-in ose degët dhe filialet e tij me qëllim ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it për konsumatorët. Ky përkufizim përfshin gjithashtu të gjithë nënagjentët e një agjenti.
² MoneyGram-i shpërndan disa produkte dhe shërbime me anë marrëveshjes që nuk janë marrëdhënie tradicionale subjekt/agjent. MoneyGram-i kryen mbikëqyrjen e këtyre kanaleve të shpërndarjes. Duke pasur parasysh ndryshimet në produktet dhe shërbimet e ofruara ose ndryshimet në kërkesat rregullatore përkatëse për këto kanale shpërndarjeje, detyrimet e kanaleve shpërndarëse jo agente mund të ndryshojnë dhe do të cilësohen me hollësi në kontratën e tyre me MoneyGram-in.

MoneyGram-it. Prandaj, MoneyGram-i parashtron më poshtë deklaratat e politikës që qeverisin sjelljen e agjentëve dhe punonjësve të tyre.

1.1 Agjentët dhe punonjësit e tyre do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse në të gjitha vendet dhe juridiksionet ku kryejnë biznesin.

- Agjentët do të marrin, mbajnë dhe afishojnë çfarëdo regjistrimi ose licence sipas kërkesave të rregullave ose ligjeve kombëtare, shtetërore/provinciale ose lokale.
- Agjentët dhe punonjësit e tyre nuk do të marrin pjesë ose nuk do të lehtësojnë me dijeni mashtrimin, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose aktivitete të tjera të paligjshme.
- Agjentët do të monitorojnë qendra mundësisht të dyshimta dhe aktivitete të punonjësve përfshirë rastet kur një punonjës apo qendër përfshihet në një numër të tepërt përjashtimesh të transaksioneve të pazgjidhura ose transaksione mundësisht të dyshimta ose kur shfaq një sjellje të pazakontë që kërkon hetim. Në qoftë se një qendër ose punonjës dyshohet se po bashkëpunon ose merr pjesë në aktivitet të paligjshëm, agjenti do të ndërmarrë veprim sipas përcaktimit të bërë në këtë politikë.

1.2 Agjentët dhe punonjësit e tyre do të sillen me ndershmëri, integritet dhe standarde etike të padiskutueshme, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në sa më poshtë:

- Agjentët dhe punonjësit e tyre do të veprojnë me ndershmëri dhe drejtësi me ata me të cilët ndërveprojnë gjatë ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it. Agjentët dhe punonjësit e tyre nuk do të ndërmarrin veprime që mund të dëmtojnë reputacionin e MoneyGram-it me konsumatorët e tyre, furnizuesit, ofruesit e shërbimeve, konkurrentët dhe zyrtarët qeveritarë.
- Agjentët dhe punonjësit e tyre nuk do ta përfundojnë një transaksion në qoftë se dyshohet se transaksioni ka lidhje me ndonjë aktivitet të paligjshëm. Produktet dhe shërbimet e MoneyGram-it duhen përdorur vetëm për qëllime të ligjshme.
- Agjentët dhe punonjësit e tyre nuk do ta shkelin këtë politikë duke përfshirë dhënien e informacionit të rremë ose mashtrues MoneyGram-it, konsumatorëve, forcave të zbatimit të ligjit ose rregullatorëve.

1.3 Agjentët do të veprojnë që të ndalin shkeljet e këtij paragrafi dhe t'ia raportojnë shqetësimet personit të duhur.

- Në qoftë se një agjent apo një punonjës i tij vihet në dijeni të ndonjë informacioni që i bën të besojnë se një agjent ose punonjës nuk i ka përmbushur kërkesat e këtij paragrafi të politikës, ata do t'ia raportojnë këtë informacion Nëpunësit Rajonal të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it të caktuar për agjentin, Përgjegjësit të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it ose Linjës së Ndhmës për Pajtueshmërinë të MoneyGram-it (shikoni "Informacion i rëndësishëm kontakti").
- Në qoftë se një agjent apo një punonjës i tij vihet në dijeni të ndonjë informacioni që i bën të besojnë se MoneyGram-i ose një punonjës i MoneyGram-it është përfshirë në sjellje joetike, të papërshtatshme ose të paligjshme ose nuk i ka përmbushur kërkesat e çfarëdo rregulloreje, rregulli apo ligji qeveritar, ata do t'ia raportojnë këtë informacion Nëpunësit Rajonal të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it të caktuar për agjentin, Përgjegjësit të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it ose Linjës së Ndhmës për Pajtueshmërinë të MoneyGram-it.
- Agjentët dhe punonjësit e tyre mund ta raportojnë një shkelje të dyshuar në mënyrë anonime duke përdorur Linjën e Ndhmës për Pajtueshmërinë të MoneyGram-it. MoneyGram-i do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar fshehtësinë e atyre që japin informacion përveçse kur MoneyGram-it i kërkohet me ligj ose sipas rregullave që ta zbulojë informacionin.
- MoneyGram-i nuk e toleron hakmarrjen në asnjë rrethanë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, hakmarrjen kundër dikujt që ka bërë një deklaram, ka raportuar një shkelje ose ka dhënë informacion si pjesë përbërëse e një hetimi. Në qoftë se një agjent ose punonjës i tyre beson se i është nënshtruar hakmarrjes ose është në dijeni të një incidenti hakmarrjeje, ata menjëherë duhet t'ia raportojnë hakmarrjen e supozuar Nëpunësit Rajonal të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it të caktuar për agjentin, Përgjegjësit të Pajtueshmërisë të MoneyGram-it ose në Linjën e Ndhmës për Pajtueshmërinë të MoneyGram-it.

1.4 Agjentët dhe punonjësit e tyre do t'u japin informacion të plotë dhe të saktë MoneyGram-it, forcave të zbatimit të ligjit ose autoriteteve rregullatore në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në situatat e mëposhtme:

- gjatë futjes së informacionit në sistemet e MoneyGram-it, dhënien personalisht të informacionit punonjësve të MoneyGram-it ose gjatë rishikimit të programeve të agjentëve.

- aty ku MoneyGram-i ka kërkuar informacion për transaksione ose për programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave.
- gjatë procesit të aplikimit, rinovimit të kontratës, rifreskimit të dosjes së agjentit ose rishikimeve për shqyrtim, rishikimeve për pajtueshmëri ose aty ku kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga MoneyGram-i;
- kur ka ndonjë ndryshim material në pronësinë dhe/ose drejtuesit ekzekutivë të agjentit; dhe
- aty ku kërkohet me ligj nga forcat e zbatimit të ligjit ose rregullatorët civilë.

2 MOSLEJIMI I RYSHFETEVE DHE KORRUPSIONIT

Ligje të ndryshme kudo në botë nuk lejojnë bërjen e pagesave jo të përshtatshme, dhënien e dhuratave jo të përshtatshme ose bujarinë për të siguruar biznes apo për të fituar një avantazh të padrejtë biznesi. Si kompani me zyra qendrore në Shtetet e Bashkuara, MoneyGram-i i nënshtrohet Aktit të Praktikave të Huaja të Korrupsionit ("FCPA") dhe ligjeve të tjera federale dhe shtetërore për ryshfetet tregtare, ashtu si edhe ligjeve përkatëse për ryshfetet tregtare dhe kundër korrupsionit në vendet e ndryshme në të cilat vepron MoneyGram-i, duke përfshirë Aktin për Ryshfetet të Britanisë së Madhe ("UKBA"). MoneyGram-i pret që agjentët e tij dhe punonjësit e tyre t'i kryejnë punët e biznesit në një mënyrë të paqortueshme, duke përfshirë pajtueshmërinë me ligjet përkatëse kundër korrupsionit, sidomos Aktin e Praktikave të Huaja të Korrupsionit dhe Aktin për Ryshfetet të Britanisë së Madhe.

- 2.1 Agjentët dhe punonjësit e tyre nuk do të përfshihen në ryshfete apo korrupsion me qëllim që të sigurojnë një avantazh të palejuar në lidhje me biznesin e MoneyGram-it, duke përfshirë ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it. Ky moslejmim ka të bëjë me çdo transaksion që përfshin qoftë zyrtarë qeveritarë apo palë tregtare.

Termi "zyrtarë qeveritarë" përfshin:

- Nëpunës ose punonjës të çfarëdo departamenti, agjencie, komisioni, byroje ose autoriteti qeveritar të çfarëdo niveli të qeverisë (kombëtar, shtetëror ose provincial, rajonal ose lokal) qofshin këta të zgjedhur, punonjës karriere ose të emëruar politikisht;
- Legjislatorët dhe gjyqtarët;
- Cilido person që vepron në kapacitet zyrtar në emër të një autoriteti publik;
- Nëpunës dhe punonjës të subjekteve që posedohen ose kontrollohen nga një autoritet publik;
- Kandidatët për zyrë politike;

- Nëpunësit dhe punonjësit e një partie politike, si dhe partia politike si institucion/subjekt;
- Nëpunësit dhe punonjësit e çfarëdo organizate publike ndërkombëtare; dhe
- Çdokush tjetër që trajtohet si zyrtar qeveritar sipas ligjeve lokale të qendrave ku vepron MoneyGram-i.
- "Palë tregtare" është çdo kompani, organizatë ose subjekt tregtar, personeli i të cilit nuk kualifikohet si "zyrtarë qeveritarë", duke përfshirë çdo punonjës, agjent, administrator ose kujdestar të një pale.

2.2 Agjentët duhet të mbajnë kontrole të mjaftueshme pajtueshmërie për të parandaluar, dekurajuar dhe zbuluar shkeljet e mundshme të këtij paragrafi në politikën dhe ligjet përkatëse kundër ryshfetit dhe korrupsionit.

3 MBAJTJA E PROGRAMEVE TË EFEKTSHME KUNDËR MASHTRIMIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE

Agjentët luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e përdorimit për aktivitet kriminal të sistemeve dhe produkteve të MoneyGram-it dhe të sistemit financiar në përgjithësi. Për këtë qëllim, MoneyGram-i u kërkon agjentëve të tij që ta ndjekin këtë politikë dhe të vënë në zbatim programet kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. Megjithatë, agjentët nuk janë pa mbështetje ndërsa e vënë në zbatim këtë politikë. MoneyGram-i u ofron mbështetje agjentëve të tij në një shumëllojshmëri mënyrash, duke përfshirë ofrimin e trajnimit dhe materialeve edukative për agjentët, të tilla si materiale për të ndihmuar agjentët që të dokumentojnë dhe zbatojnë programet e tyre kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. Përveç kësaj, MoneyGram-i ndihmon në sigurimin e efektivitetit të programit të pajtueshmërisë të agjentit nëpërmjet vlerësimit të kryer gjatë shoqërizimit organizacional dhe në mënyrë të vazhdueshme. MoneyGram-i kërkon një rrugë komunikimi të hapur me agjentët ndërsa ata përmbushin detyrimet e parashtruara më poshtë.

3.1 Agjentët e MoneyGram-it do të përmbahen dhe veprojnë sipas programeve dhe politikave të shkruara, efektive dhe të bazuara në rrezik që janë të mjaftueshme për të ndihmuar në parandalimin e mashtrimit të konsumatorit dhe për të përmbushur kërkesat përkatëse kundër pastrimit të parave, të pajtueshmërisë dhe/ose kërkesa të tjera rregullatore.

- Agjentët do t'i kryejnë veprimtaritë e tyre duke përdorur një metodë të bazuar në rrezik, siç është demonstruar nga adoptimi dhe vënia në zbatim e sistemeve të raportimit dhe monitorimit të transaksioneve të përshkruara më poshtë dhe duhet të kuptojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe mashtrimit të paraqitur nga vendndodhja gjeografike e agjentit, konsumatorët të cilëve u shërben agjenti dhe produktet e ofruara nga agjenti.

- Agjentët do të adoptojnë dhe vënë në zbatim programe kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave duke u bazuar në rrezikun e biznesit të agjentit të cilat përmbushin, në minimum, kërkesat e mëposhtme:
 - Shqyrtimi i caktimit të një nëpunësi të pajtueshmërisë, trajnim i punonjësve, raportim dhe monitorim të transaksioneve, marrjen dhe mbajtjen e informacionit të konsumatorëve dhe, nëse kërkohet, rishikimin e pavarur të programeve të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. Këto kërkesa janë përvijuar më në hollësi më poshtë;
 - Merrni aprovim nga pronari dhe drejtuesit e agjentit, duke përfshirë përkushtimin për të mbështetur dhe vepruar sipas kësaj politike dhe programeve të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave;
 - Vini në zbatim programe të efektshme për të monitoruar transaksionet dhe transaksionet e tentuara të kryera në qendrat e tyre dhe raportojuani aktivitetin e dyshimtë autoriteteve përkatëse siç kërkohet nga ligjet përkatëse dhe/ose përshpejtoni dërgimin e informacionit MoneyGram-it. Disa shembuj situatash që i duhen përshpejtuar MoneyGram-it përfshijnë sa më poshtë:
 - Agjenti që beson se ka gjasa që aktiviteti i dyshimtë po ndodh përtej ose jashtë rrjetit të tyre dhe mund të përfshijë qendra të tjera të agjentëve të MoneyGram-it jashtë rrjetit të tyre (nëse është e zbatueshme);
 - Agjenti që është i shqetësuar për një transferim ndërkufitar dhe që beson se duhen vënë në dijeni forcat e zbatimit të ligjit jashtë vendit të tyre;
 - Agjenti i cili identifikon diçka që ai beson të jetë një tendencë ose metodë e dyshimtë ose a pazakontë në zhvillim e sipër; ose
 - Agjenti që është i shqetësuar se transaksioni mund të përfshijë financim të terrorizmit. Nëse ndodh një rast i tillë, agjenti duhet të kontaktojë menjëherë MoneyGram-in dhe forcat e zbatimit të ligjit.
 - Në qoftë se agjenti ndodhet në një vend i cili kërkon që raportimi i aktivitetit të dyshimtë duhet të vijë direkt nga MoneyGram-i, rezultatet e monitorimit si dhe çfarëdolloj informacioni i lidhur me të duhet t'i jepen MoneyGram-it nga agjenti brenda një periudhe kohe të arsyeshme ose sipas kërkesës së çfarëdo rregulli apo ligji përkatës.
 - Monitoroni transaksionet për aktivitete mundësisht të pazakonta ose të dyshimta, të tilla si strukturimi i mundshëm i transaksioneve për të shmangur kërkesat e raportimit ligjor dhe/ose rregullator, shmangia e kërkesave të identifikimit, praktika e shkëmbimit të dokumenteve të

identifikimit dhe çfarëdo sjellje tjetër e pazakontë e tillë si një person që i dërgon para disa individëve në disa vende të ndryshme;

- Dokumentoni rezultatet e monitorimit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave, duke përfshirë dorëzimin e raporteve për çfarëdolloj aktiviteti të dyshimtë te rregullatori përkatës dhe/ose përshpejtimin e raportimit te MoneyGram-i për aktivitetin mundësisht të dyshimtë;
 - Ofroni procedura dhe politika me shkrim për t'u ndjekur nga punonjësit që ata të zbulojnë dhe parandalojnë transaksionet ose transferimet e parave me qëllim mashtrimi, të strukturuar ose përndryshe të paligjshme;
 - Ofroni procedura dhe politika me shkrim për t'u ndjekur nga punonjësit që ata të raportojnë aktivitetin mundësisht të dyshimtë ose transaksione të mëdha në para dhe që të përmbushin çfarëdolloj detyrimesh të tjera rregullatore raportimi në juridiksionin në të cilin vepron agjenti. Procedura dhe politika të tilla duhet të shqyrtojnë detyrimet në lidhje me "mosinformimin" e konsumatorit kur është bërë raportim i një aktiviteti të dyshimtë; dhe
 - Jepuni udhëzime punonjësve se si të përshpejtojnë raportimin te MoneyGram-i për një aktivitet mundësisht të dyshimtë kur është e nevojshme.
- Agjentët brenda Shteteve të Bashkuara si dhe agjentët jashtë Shteteve të Bashkuara me dhjetë ose më shumë qendra do të plotësojnë rishikime të pavarura, të bazuara në rrezik, për të vlerësuar efektivitetin e programeve të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave ("Rishikime të pavarura"). Këto rishikime të pavarura do të kryhen periodikisht ose aq shpesh sa kërkohen nga ligjet, rregullat përkatëse ose MoneyGram-i. Rishikimet e pavarura do të dokumentohen me shkrim dhe agjenti do të dokumentojë veprimet që ka marrë si kundërpërgjigje ndaj mangësive të identifikuar nga rishikimet e pavarura. Rishikimet e pavarura do të marrin parasysh mjaftueshmërinë e:
 - programeve me shkrim të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave;
 - autoritetit dhe ekspertizës së nëpunësit të pajtueshmërisë të agjentit;
 - trajnimit të punonjësve;

- raportimit dhe monitorimit të transaksioneve duke përfshirë dorëzimin e raporteve për aktivitete të dyshimta dhe/ose përshkallëzimin e raportimit të MoneyGram-i të aktivitetit të dyshimtë, kur është e nevojshme; dhe
- çfarëdo mangësie tjetër lidhur me vënien në zbatim dhe veprimin sipas kësaj politike.
- Agjentët do të caktojnë një nëpunës pajtueshmërie i cili përgjigjet për vënien në zbatim dhe veprimin sipas programeve të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. Nëpunësi i pajtueshmërisë duhet, në minimum, të përmbushë kërkesat e mëposhtme:
 - të jetë i përkushtuar për të mbështetur dhe vepruar në përputhje me këtë politikë dhe programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave;
 - të jetë i aftë për të vënë në zbatim dhe mirëmbajtur programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave;
 - të jetë i fuqizuar me autoritetin e nevojshëm për të vënë në zbatim programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave nëpër të gjithë rrjetin e tij, nëse ka të bëjë;
 - të mbështetet nga pronari dhe drejtuesit e agjentit dhe të mbajë titullin si nëpunës ose menaxher me linja direkte komunikimi me pronarin ose drejtuesit;
 - të jetë i autorizuar që të sigurojë rishikime të pavarura në bazë rreziku të programeve të agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave, nëse ka të bëjë; dhe
 - të ketë njohuri për biznesin e përditshëm të agjentit, duke përfshirë ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it.
- Agjentët duhet të sigurohen se kanë staf dhe burime të mjaftueshme për të vënë siç duhet në zbatim këtë politikë dhe politikat e programet që ka adoptuar agjenti.
- Çdo delegim ose shpërndarje detyrash sipas kësaj politike duhet parashtruar qartë me shkrim nga agjenti dhe aprovuar nga nënagjentët (kjo ka të bëjë vetëm me marrëdhënie të caktuara të agjentëve jashtë Shteteve të Bashkuara). Pavarësisht nga delegimi ose shpërndarja e detyrave, agjentët duhet të sigurohen që nënagjentët që punojnë nën agjentin të veprojnë në përputhje me kërkesat e kësaj politike.

4 TRAJNIMI I PUNONJËSVE TË AGJENTËVE

Siç u përmend më lart, agjentët dhe punonjësit e tyre janë fronti i parë mbrojtës për mbrojtjen e konsumatorëve dhe parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit kriminal të produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it. Agjentit dhe punonjësve duhet t'u jepet trajnimi dhe instrumentet e nevojshme për të parandaluar ndodhjen e gabimeve ose abuzimit gjatë përdorimit të produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it. Për më tepër, si pjesë përbërëse e trajnimit të punonjësve, agjentët duhet t'u komunikojnë punonjësve të tyre se drejtuesit e agjentit mbështesin pajtueshmërinë e plotë me rregullat dhe ligjet përkatëse. MoneyGram-i kërkon që agjenti të lejojë vetëm punonjës të trajnuar siç duhet që t'u ofrojnë konsumatorëve produkte dhe shërbime të MoneyGram-it.

- 4.1 Agjentët duhet të sigurohen që punonjësit janë trajnuar siç duhet për të përpunuar transaksione duke përdorur sistemet e MoneyGram-it dhe se do të veprojnë në përputhje me këtë politikë dhe programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. MoneyGram-i po i përmirëson vazhdimisht politikat dhe programet e tij dhe mund t'i përditësojë përgjegjësitë e agjentit në çdo kohë duke u bazuar në ligjet, rregullat, praktikat më të mira të sektorit dhe rrezikun. Agjentët kanë përgjegjësinë që t'ua komunikojnë këto ndryshime punonjësve të tyre dhe çdo nënagjenti (ka të bëjë vetëm me disa marrëdhënie të caktuara me agjentët jashtë Shteteve të Bashkuara) dhe të sigurojnë vënien e tyre në zbatim.
- 4.2 Agjentët do të trajnojnë të gjithë punonjësit që ndërveprojnë me konsumatorët të cilët përdorin produktet dhe shërbimet e MoneyGram-it në lidhje me masat kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave ose duke përdorur trajnimin e ofruar nga MoneyGram- i ose trajnim ekuivalent. Ky trajnim do të bëhet të paktën çdo dy vjet ose më shpesh sipas kërkesës nga rregullat apo ligjet lokale ose nga MoneyGram-i. Ky trajnim duhet të përfshijë sa vijon më poshtë:
 - veprimin në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në këtë politikë;
 - identifikimin e skemave mashtruese të konsumatorëve dhe parandalimin e transferimeve me qëllim mashtrimi;
 - verifikimin e identifikimit të konsumatorëve;
 - pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat përkatëse të përpunimit të transaksioneve, duke përfshirë marrjen e saktë të të dhënave dhe procedurat e futjes së tyre;
 - identifikimin dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë dhe transaksioneve të strukturuar; dhe

- përmbushjen e kërkesave për mbajtjen e të dhënave.
- 4.3 Agjentët kanë përgjegjësinë që të sigurohen që punonjësit i kuptojnë përgjegjësitë e tyre dhe të ofrojnë trajnim rifreskues për punonjësit sipas nevojës. Përveç këtyre, agjentët do të ofrojnë trajnim shtesë të punonjësve në rastin kur identifikohet një çështje e rendimentit të punës në lidhje me pajtueshmërinë me këtë politikë ose me procedurat apo politikat kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave. Punonjësit duhet të testohen në lidhje me njohuritë e tyre për të demonstruar se i kuptojnë përgjegjësitë e tyre të pajtueshmërisë.
- 4.4 Agjentët do të dokumentojnë dhe mbajnë të gjithë dokumentacionin e trajnimit. Këto dokumente duhen mbajtur në dosjet e personelit të punonjësve dhe/ose në sistemin e menaxhimit të trajnimit të MoneyGram-it dhe t'i jepen MoneyGram-it ose autoriteteve përkatëse qeveritare sipas kërkesës.

5 BASHKËPUNIMI ME FORCAT E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE RREGULLATORËT

MoneyGram-i hyn në partneritet me forcat e zbatimit të ligjit kudo në botë për të kërkuar arrestimin dhe dënimin e atyre që përpiqen të përfshihen në aktivitete të paligjshme duke përdorur produktet dhe shërbimet e MoneyGram-it. Përveç kësaj, MoneyGram-i dhe agjentët e tij i nënshtrohen ekzaminimit për pajtueshmërinë me ligjet, rregullat dhe procedurat e politikave të MoneyGram-it nga autoritetet qeveritare në shumë juridiksione. Rregullatorët qeveritarë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit mund të kërkojnë informacion dhe dokumentacion herë pas here.

- 5.1 Agjentët do të bashkëpunojnë plotësisht me MoneyGram-in dhe forcat e zbatimit të ligjit dhe/ose agjencitë rregullatore kur kontaktohen në lidhje me çështje të pajtueshmërisë për mashtrimin e konsumatorëve dhe kundër pastrimit të parave deri në pikën maksimale të lejuar me ligj. Në qoftë se përgjigjja ndaj kërkesës është jashtë aftësisë së tij, agjenti duhet menjëherë të kontaktojë MoneyGram-in për ndihmë (*shikoni* "Informacion i rëndësishëm kontakti").
- 5.2 Çdo person i lidhur ose që ka lidhje me një agjent dhe që merr ose të cilit i shërbehet një letërthirrje, fletëthirrje në gjyq, urdhër gjyqi ose kërkesë tjetër formale në lidhje me produktet, shërbimet ose biznesin e MoneyGram-it duhet të kontaktojë menjëherë MoneyGram-in, në qoftë se kjo lejohet nga ligji ose rregullorja përkatëse (*shikoni* "Informacion i rëndësishëm kontakti").
- 5.3 Agjentët dhe punonjësit e tyre do të bashkëpunojnë dhe do t'u përgjigjen me përpikmëri të gjitha kërkesave të ligjshme për informacion duke përfshirë:
- çdo kërkesë nga MoneyGram-i për dokumentacion ose informacion tjetër;
 - çdo kontroll rregullator, inspektim, testim të pavarur ose rishikim të pajtueshmërisë së biznesit të agjentit; dhe

- çdo kërkesë të përshtatshme qeveritare për dokumentacion duke përfshirë fletëthirrje në gjyq, urdhra prodhimi ose kërkesa të tjera të lidhura me shitjen nga ana e agjentit të produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it.

6 KËRKESAT E TRANSAKSIONEVE DHE MBAJTJES SË DOKUMENTACIONIT

Thelbi i produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it janë transaksionet që përpunon. Është e nevojshme që agjentët dhe punonjësit e tyre (nëse është e zbatueshme) të marrin informacion të plotë dhe të saktë për t'u siguruar që transaksionet e MoneyGram-it të përpunohen me saktësi dhe me efektshmëri. Agjentët dhe punonjësit e tyre (nëse është e zbatueshme) marrin lloje të ndryshme informacioni përgjatë gjithë procesit të transaksionit, duke përfshirë jo vetëm informacionin dokumentar, por edhe informacionin e sjelljes/jogojor nga konsumatorët (kur transaksionet kryhen personalisht) të tilla si gjuha e trupit dhe toni i zërit. Informacioni i marrë dhe i vëzhguar mund të jetë i vlefshëm për të parandaluar përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të MoneyGram-it për qëllime të paligjshme dhe mund të ndihmojë si MoneyGram-in ashtu edhe agjentin në përmbushjen e detyrimeve të tyre kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave, duke përfshirë raportimin e aktivitetit të dyshimtë. Përveç kësaj, agjentët duhet të ndjekin ligjet dhe rregullat që qeverisin ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me transaksionet, aktivitetin e dyshimtë dhe raporte të tjera rregullatore.

- 6.1 Agjentët e ndodhur në Shtetet e Bashkuara ose në qendra brenda Shteteve të Bashkuara, duhet të mbajnë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e raportimit të kërkuara nga Akti i Fshehtësisë së Bankave ("BSA") për një minimum prej pesë (5) vjetësh (ose më gjatë nëse specifikohet nga një rregull specifik i shtetit³) në një vend të sigurt dhe të siguruar dhe ta kenë në dispozicion të Departamentit Amerikan të Thesarit dhe/ose përfaqësuesve nga zyrtarë të qeverive të tjera me kërkesë të ligjshme.
- 6.2 Agjentët e ndodhur jashtë Shteteve të Bashkuara, ose në qendra jashtë Shteteve të Bashkuara, duhet të mbajnë të gjithë dokumentacionin e transaksioneve dhe shqyrtimeve të konsumatorëve për të vepruar në përputhje me kërkesat për informacion për pesë (5) vjet (ose më gjatë nëse kërkohet nga organet lokale) siç rekomandohet nga Njësia Operative Speciale e Veprimeve Financiare ("FATF") në lidhje me pastrimin e parave.
- 6.3 Agjentëve u kërkohet që të ruajnë dokumentacionin që dëshmon përpjekjet e tyre për të monitoruar, parandaluar dhe raportuar mashtrimin nga konsumatori, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit për një minimum prej pesë (5) vjetësh (ose më gjatë nëse kërkohet nga rregullat dhe ligjet lokale).

³ Përveç BSA-së, agjentët e ndodhur në Shtetet e Bashkuara ose në qendra brenda Shteteve të Bashkuara, duhet të mbajnë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e raportimit të kërkuar nga Akti i Transferimit të Fondeve Elektronike ("EFTA") dhe Rregullorja E (e njohur gjithashtu si Rregulli i Transferimit të Fondeve të Dërguara) për një minimum prej dy (2) vjetësh (ose më gjatë nëse specifikohet nga rregullorja shtetërore) në një vend të sigurt dhe të siguruar, duke përfshirë faturën / kopjen e agjentit.

- 6.4 Agjentët dhe punonjësit e tyre duhet t'i paralajmërojnë konsumatorët përpara përfundimit të transaksionit të tyre në lidhje me "skemat" e mashtrimit duke iu referuar paralajmërimeve në formularin e dërgimit (aty ku ka të bëjë) ose paketimeve të tjera përkatëse për produktet.
- 6.5 Agjentët dhe punonjësit e tyre do të sigurohen që:
- Aty ku është e zbatueshme, formularët e dërgimit dhe marrjes të jenë plotësuar plotësisht dhe me saktësi dhe të jenë nënshkruar nga konsumatori.
 - Të merret informacioni i vlefshëm i identifikimit të konsumatorit para se të përpunohet transaksioni në përputhje me kërkesat lokale dhe procedurat e politikën e MoneyGram-it.
 - Informacioni i plotë dhe i saktë i identifikimit të konsumatorit futet në sistemet e MoneyGram-it për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe për të minimizuar vonesat në përpunimin e transaksionit.
 - Transaksionet që duken të pazakonta ose mundësisht të lidhura me pastrimin e parave ose aktivitete të tjera të paligjshme duhet t'i raportohen autoritetit përkatës siç kërkohet nga rregullat dhe ligjet përkatëse dhe/ose duhet përsheptuar raportimi i tyre te MoneyGram-i aty ku duhet.
 - Konsumatorëve që duket se janë përfshirë në një transaksion me qëllim mashtrimi u bëhen pyetje në lidhje me transaksionin e tyre. Në qoftë se ekziston një dyshim i arsyeshëm se transaksioni ka qëllim mashtrimi, agjenti ose punonjësi i tyre duhet të refuzojë përpunimin e transaksionit dhe t'ia raportojë një aktivitet të tillë sa më shpejt që të jetë e arsyeshme MoneyGram-it dhe autoriteteve përkatëse, aty ku kërkohet nga rregullorja ose ligji përkatës.
 - Konsumatorët të cilët i raportojnë një agjenti ose punonjësit të tij se kanë qenë viktimë e një transaksioni me qëllim mashtrimi duhen inkurajuar që t'i raportojnë veçmas transaksionet me qëllim mashtrimi te MoneyGram-i dhe/ose autoritetet përkatëse.
- 6.6 Përpara dhënies së fondeve konsumatorit, agjenti dhe punonjësit e tij duhet t'i kërkojnë konsumatorit numrin e referencës dhe ta fusin këtë numër në sistemet e MoneyGram-it.

7 TË DREJTAT E KONSUMATORËVE

MoneyGram-i i është përkushtuar mbrojtjes së konsumatorëve të tij nga praktikat e biznesit joetik ose të paligjshëm. MoneyGram-i pret që agjentët dhe punonjësit e tyre të minimizojnë rrezikun e dëmit ndaj konsumatorëve dhe të parandalojnë ndodhinë e veprave apo praktikave të padrejta, mashtruese apo abuzive ("UDAAP") ose shkeljet e ligjeve të tjera përkatëse të mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet të gjitha mënyrave që mund të praktikohen në mënyrë të arsyeshme sipas ligjeve dhe rregullave.

- 7.1 Agjentët do t'u japin konsumatorëve të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me çdo transaksion, duke përfshirë informacion që ka të bëjë me tarifën dhe sasinë e pagesës që do të bëjë konsumatori për çdo transaksion.
- 7.2 Agjentët mund të ofrojnë vetëm produkte dhe shërbime të MoneyGram-it në gjuhët e aprovuara dhe të autorizuara nga MoneyGram-i.
- 7.3 Agjentët mund të përdorin vetëm reklama dhe materiale marketingu të aprovuara nga MoneyGram-i. Këto përfshijnë tabela të brendshme dhe të jashtme, pamflete promovimi, reklama në revista lokale dhe afishe mbi banak.
- 7.4 Sistemet e MoneyGram-it janë formuar në mënyrë specifike për të prodhuar llojet e deklaratave të parapagesave dhe paspagesave që kërkohen nga rregullat dhe ligjet përkatëse, duke përfshirë Rregullat e Fondeve të Dërguara të Shteteve të Bashkuara. Agjentët nuk lejohen t'u bëjnë ndryshime deklaratave të parapagesës dhe paspagesës të dhëna nga MoneyGram-i ose të prodhuara nga pajisjet e MoneyGram-it.

8 PRIVATËSIA E KONSUMATORIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

MoneyGram-i ofron mënyra të sigurta dhe të lehta për të dërguar dhe marrë para. Pjesë e përkushtimit të MoneyGram-it ndaj konsumatorëve të tij është që të mbrojnë informacionin e tyre personal dhe privat. Gjatë përpilimit të transaksioneve, agjentët dhe punonjësit e tyre mund të marrin informacion privat dhe personal nga konsumatorët të tillë si emrin, adresën, numrin e telefonit, ID-në/identifikimin qeveritar ose numrin identifikues të taksave, numrin e pasaportës, numrin e llogarisë bankare, numrin e kartës debitore ose të kreditit, vendin ose datën e lindjes, profesionin, adresën e emailit dhe çfarëdo shqyrtim tjetër të kërkuar për konsumatorin. MoneyGram-i pret që agjentët dhe punonjësit e tyre ta mbrojnë këtë informacion nga kontakti, përdorimi dhe zbulimi i paautorizuar.

- 8.1 Agjentët do ta mbrojnë informacionin privat dhe personal të konsumatorëve në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse për të parandaluar kontaktin, përdorimin dhe zbulimin e paautorizuar.
- 8.2 Programet e agjentit kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave do të përfshijnë procedura në përputhje me ligjet e privatësisë dhe për të garantuar sigurinë e të

dhënave. Procedura të tilla do të vihen në zbatim në përpjesëtim me llojin e informacionit të marrë e të magazinuar dhe operacionet e biznesit të agjentit.

- 8.3 Agjentët dhe punonjësit e tyre do të marrin nga konsumatorët vetëm informacionin e nevojshëm për të përfunduar transaksionin. Agjentët dhe punonjësit e tyre do ta përdorin informacionin e konsumatorit vetëm për qëllime të identifikuar dhe të lejuara siç parashikohet në kushtet dhe konditat që gjenden në dokumentet që i janë dhënë konsumatorëve. Përveç rasteve kur autorizohet nga MoneyGram-i, informacioni i konsumatorit mund të përdoret vetëm (i) për të përfunduar një transaksion të konsumatorit; (ii) për të plotësuar detyrimet ligjore/rregullatore; dhe (iii) për të parandaluar pastrimin e parave dhe/ose mashtrimin.
- 8.4 Agjentët do t'ia japin informacionin e konsumatorit vetëm individit që ka lidhje me të dhe nuk do t'ia japin informacionin e konsumatorit asnjë pale të tretë të paautorizuar.
- 8.5 Agjentët do ta mbajnë informacionin personal të konsumatorit vetëm për atë kohë që është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e deklaruar ose siç kërkohet me ligj. Të gjithë dokumentet që përmbajnë informacion personal dhe privat të konsumatorëve do të magazinohen në një vend të sigurt. Në qoftë se agjenti përdor instrumente për të ndihmuar në monitorimin e transaksionit, ai duhet të ndjekë protokolle përkatëse për sigurinë e të dhënave.
- 8.6 Agjentët duhet të sigurojnë shkatërrimin e duhur të informacionit personal të konsumatorit në fund të periudhës mbajtëse.
- 8.7 Agjentët duhet të sigurohen që çdo punonjës të ketë një ID përdoruesi dhe fjalëkalim individual të cilat nuk do të shkëmbehen me punonjësit e tjerë.
- 8.8 Agjentët dhe punonjësit e tyre do ta kufizojnë veten dhe do të parandalojnë përdorimin e hardware-it të kompjuterit, software-it, komunikimeve dhe sistemeve të rrjetit të MoneyGram-it për përdorim personal ose përdorim që nuk ka lidhje me biznesin e MoneyGram-it. Agjentët do ta mbrojnë kompjuterin e tyre të transferimit të parave nga kontakti i paautorizuar dhe nuk duhet ta përdorin kompjuterin e transferimit të parave për të bërë kërkime në internet, për emaila ose mesazhe tekst (IM) sepse këto janë metodat më të zakonshme nëpërmjet të cilave kompjuterat infektohen me viruse dhe/ose software mashtrimi që mund të çojnë në transaksione mashtruese. Ekranet e kompjuterave nuk duhet të shikohen nga publiku. Agjentët duhet të instalojnë software të duhur antivirus dhe mure mbrojtës si dhe ta programojnë software-in që të shkarkojë automatikisht korrigjime dhe përmirësime për të rregulluar pikat e dobëta të sigurisë.

8.9 Agjentët do të raportojnë çdo incident gjatë të cilit fshehtësia ose siguria e informacionit personal të konsumatorit është zbuluar ose dyshohet të jetë zbuluar, keqpërdorur ose kompromentuar menjëherë si te drejtuesit përkatës të agjentit ashtu edhe te MoneyGram-i (*shikoni "Informacion i rëndësishëm kontakti"*) me qëllim përcaktimin e pasojave të mundshme për agjentin, konsumatorët dhe MoneyGram-in.

9 KTHIMI I FONDEVE KONSUMATORËVE

Ka raste kur bëhen gabime kur përpunohet një transaksion. MoneyGram-i ka vendosur procedura në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse, duke përfshirë Rregullat e Fondeve të Dërguara të Shteteve të Bashkuara që mbulojnë rastet kur konsumatorit duhet t'i kthehen fondet. Agjentët duhet të punojnë me konsumatorin dhe MoneyGram-in për të zgjidhur çfarëdo gabimi në transaksion. Për më tepër, MoneyGram-i pret që agjentët e tij të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të parandaluar shpërndarjen e transaksioneve me qëllim mashtrimi dhe ta bëjnë kthimin e fondeve në përputhje me procedurat e MoneyGram-it si dhe ligjet lokale për mbrojtjen e konsumatorëve.

9.1 Në qoftë se dërguesi ose marrësi beson se është bërë një gabim, kontaktoni menjëherë MoneyGram-in. MoneyGram-i do ta hetojë gabimin e supozuar dhe do të vendosë nëse duhet t'i kthehen fonde konsumatorit.

9.2 Agjentët do ta ndihmojnë MoneyGram-in në kthimin e fondeve konsumatorëve aty ku është e zbatueshme.

9.3 Agjentët do ta këshillojnë konsumatorin që të kontaktojë menjëherë MoneyGram-in në qoftë se konsumatori beson se ata kanë dërguar një transaksion me qëllim mashtrimi, edhe në qoftë se agjenti nuk mund t'ia kthejë fondet konsumatorit.

10 MONITORIMI DHE VEPRIMI KORRIGJUES

MoneyGram-i monitoron se sa mirë i kryejnë agjentët përgjegjësitë e tyre në lidhje me pajtueshmërinë. Kjo përfshin monitorimin e transaksioneve të përpunuara nga agjenti. Sipas gjykimit të tij, MoneyGram-i kryen rishikime të programeve të agjentëve për pajtueshmërinë me politikën kundër mashtrimit dhe pastrimit të parave, blerjet e mistershme, hetimet në vend dhe aktivitete të tjera rishikimi në lidhje me pajtueshmërinë për t'u siguruar që agjenti ka krijuar dhe vënë në zbatim një program të efektshëm pajtueshmërie që i përshtatet modelit të biznesit të agjentit dhe se agjenti po ndjek kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatore, procedurat dhe politikat e MoneyGram-it dhe/ose kërkesat kontraktuese.

10.1 Sjellja që mund të çojë në monitorim ose veprim korrigjues

- Të gjithë agjentët që e shkelin këtë politikë ose ndonjë ligj apo rregullore përkatëse do t'i nënshtrohen menjëherë veprimit korrigjues ose ndreqës, duke

përfshirë periudhë prove, pezullim të shërbimit ose ndërprerje të shërbimeve të MoneyGram-it.

- MoneyGram-i mund të ndërmarrë veprim korigjues ose ndreqës, duke përfshirë periudhën e provës, pezullimin e shërbimit ose ndërprerjen e shërbimeve të MoneyGram-it, në qoftë se vendos, në bazë të gjykimit të tij të vetëm, se sjellja e agjentit përbën një rrezik të palejuar për konsumatorët ose për sistemet apo reputacionin e MoneyGram-it. Sjellja që mund të çojë në veprime korigjuese ose ndreqëse përfshin përpunimin e transaksioneve të dyshimta ose me qëllim mashtrimi.
- Çdo agjent që gjendet duke ndihmuar ose marrë pjesë në aktivitete transaksionesh të paligjshme do t'i nënshtrohet pezullimit ose ndërprerjes së menjëhershme të shërbimeve të MoneyGram-it, në mungesë të rrethanave lehtësuese të dokumentuara.

10.2 Monitorimi dhe veprimet korigjuese të mundshme

- MoneyGram-i mund të zgjedhë që të ndërmarrë një shumëllojshmëri veprimesh korigjuese ose ndreqëse për të shqyrtuar sjelljen e parashtruar në paragrafin 10.1 më sipër. Këto veprime mund të përfshijnë:
 - ndërprerjen e shërbimeve të MoneyGram-it;
 - pezullimin e të drejtës për të kryer transferime të parave nëpërmjet MoneyGram-it ose transaksione të tjera;
 - vendosjen e kufizimeve në shërbimet e MoneyGram-it, duke përfshirë: (i) uljen e kufijve për procedurat e identifikimit të konsumatorëve; (ii) uljen e sasisë së transaksioneve ose kufizimet në shumën e transferuar; (iii) kërkimin e aprovimit ekspres nga MoneyGram-i për transaksione mbi një shumë të caktuar; dhe (iv) masa të tjera kufizuese që konsiderohen të nevojshme nga MoneyGram-i; dhe
 - ç.vendosjen e agjentit në një periudhë prove gjatë të cilës MoneyGram-i do të monitorojë nga afër transaksionet e agjentit. Në ato raste kur agjenti vendoset në periudhë prove, transaksionet MoneyGram të agjentit do të monitorohen për një periudhë prej 90 ditësh ose deri në një periudhë kohe që MoneyGram-i e konsideron të mjaftueshme.
- Përveç këtyre, MoneyGram-i mund të ndërmarrë veprime të tjera ndreqëse veçmas ose së bashku me ato që janë shënuar në listë në paragrafin 10.2. Këto veprime mund të përfshijnë:

- kontaktin me agjentin çdo 30 ditë për të marrë raporte në lidhje me veprimet që ai ka ndërmarrë për t'iu përgjigjur çështjeve të identifikuara;
- kërkimin dhe rishikimin e dokumentacionit të agjentit; dhe
- shqyrtimin e analizës së transaksioneve me agjentin çdo 30 ditë.

10.3 Agjentët do t'i përgjigjen dhe do të vënë në zbatim të gjitha veprimet korrigjuese ose ndreqëse të kërkuara nga MoneyGram-i për të shqyrtuar shkeljet ose mangësitë në veprimin në përputhje me këtë politikë. MoneyGram-i do t'i ndërpresë shërbimet e tij me agjentët të cilët nuk i përgjigjen ose nuk i vënë në zbatim veprimet korrigjuese ose ndreqëse të kërkuara nga MoneyGram-i.

10.4 Cilido agjent që beson se i është nënshtruar në mënyrë të padrejtë veprimit korrigjues ose ndreqës do të kontaktojë Përgjegjësën e Pajtueshmërisë të MoneyGram-it te:

MoneyGram International, Inc.
Attn: Chief Compliance Officer
2828 North Harwood Street, 15th Floor
Dallas, TX 75201
Telefoni: (+01) 214-999-7640

10.5 Veprimet korrigjuese të lidhura me punonjësit e agjentit

- Agjentët do të bëjnë hetim dhe do t'i raportojnë autoriteteve përkatëse dhe MoneyGram-it çdo situatë ku një punonjës dyshohet për pjesëmarrje në pastrimin e parave, mashtrimin e konsumatorëve ose financimin e terrorizmit.
- Agjentët nuk duhet të lejojnë që punonjësit të cilët dyshohen për pjesëmarrje në pastrimin e parave, mashtrimin e konsumatorëve ose financimin e terrorizmit të kryejnë transaksione të MoneyGram-it dhe të mos lejojnë që punonjësi të ketë kontakt me sistemet e MoneyGram-it.
- Në qoftë se agjenti, gjatë hetimit, beson se një punonjës i cili më parë dyshohej për pjesëmarrje në pastrimin e parave, mashtrimin e konsumatorëve ose financimin e terrorizmit, në fakt nuk mori pjesë në këto aktivitete, atëherë agjenti do të marrë aprovim nga MoneyGram-i përpara se ta lejojë punonjësin që të ketë kontakt me sistemet e MoneyGram-it.

INFORMACION I RËNDËSISHËM KONTAKTI

PËRGJEGJËSI I PAJTUESHMËRISË

Ekipi ynë i pajtueshmërisë është në dispozicion te:

MoneyGram International, Inc.
 Attn: Chief Compliance Officer
 2828 North Harwood Street, 15th Floor
 Dallas, TX 75201
 Telefoni: (+01) 214-999-7640

Arsyeja e kontaktit	Informacioni i kontaktit të MoneyGram-it
<p>Linja e ndihmës</p> <p>Agjentët dhe punonjësit e tyre kanë mundësinë që të kontaktojnë menjëherë MoneyGram-in nëpërmjet telefonit për të ndaluar një transaksion me qëllim mashtrimi ose për të bërë, me telefon ose email, një raport të fshehtë dhe anonim në lidhje me shkeljet e etikës. Linja e ndihmës duhet përdorur në situatat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për të raportuar një transaksion konsumatori që duket se është me qëllim mashtrimi në proces e sipër dhe kërkon vëmendje të menjëhershme. • Për të raportuar shkelje nga ana e agjentit ose punonjësit të agjentit të kërkesave etike dhe ligjore të politikës së pajtueshmërisë të partnerëve globalë të MoneyGram-it. • Për të raportuar shkelje nga MoneyGram-i ose punonjësit e MoneyGramit të kërkesave etike dhe ligjore të politikës së pajtueshmërisë të partnerëve globalë të MoneyGram-it. • Për të raportuar raste kur një agjent ose punonjësi i tij dyshohet për pjesëmarrje në pastrimin e parave, mashtrimin e konsumatorëve ose financimin e terrorizmit. 	<p>Raportimi i mashtrimit</p> <p>TELEFONI në Shtetet e Bashkuara 1-800-866-8800</p> <p>jashtë Shteteve të Bashkuara http://corporate.moneygram.com/compliance</p> <p>Raportimi i shkeljeve</p> <p>TELEFONI Shtetet e Bashkuara 1-800-866-8800 në anglisht ose spanjisht</p> <p>NË INTERNET Plotësoni formularin në internet duke vizituar http://corporate.moneygram.com/compliance</p>
<p>Raportimi i përshpejtuar i aktivitetit mundësisht të dyshimtë ose të pazakontë</p> <p>Agjentët dhe punonjësit e tyre kanë mundësinë që menjëherë t'i raportojnë MoneyGram-it informacionin që ka të bëjë me një aktivitet mundësisht të dyshimtë ose të pazakontë, duke përfshirë raste të dyshimta të mashtrimit të konsumatorëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportoni informacionin që ka të bëjë me një aktivitet mundësisht të dyshimtë ose të pazakontë të konsumatorit duke përfshirë aktivitete të tentuara nga konsumatorët. • Raportoni transaksione të konsumatorëve që duket se janë me qëllim mashtrimi dhe që nuk janë më në proces e sipër. 	<p>TELEFONI Shtetet e Bashkuara 1-800-866-8800 në anglisht ose spanjisht</p> <p>NË INTERNET Plotësoni formularin në internet duke vizituar http://corporate.moneygram.com/compliance</p>

Arsyeja e kontaktit	Informacioni i kontaktit të MoneyGram-it
<p>Ndihma me kërkesat rregullatore ose nga forcat e zbatimit të ligjit</p> <p>Agjentët dhe punonjësit e tyre mund të kontaktojnë MoneyGram-in për çfarëdolloj pyetjeje në lidhje me kërkesa ose pyetje rregullatore ose nga forcat e zbatimit të ligjit.</p>	<p>EMAILI MGILEDirect@moneygram.com</p>
<p>Ndihma me kërkesat për privatësinë e konsumatorit dhe mbrojtjen e të dhënave</p> <p>Agjentët dhe punonjësit e tyre duhet të kontaktojnë MoneyGram-in menjëherë për të raportuar çdo incident në të cilin fshehtësia ose siguria e ndonjë informacioni personal të konsumatorit është ose dyshohet të jetë zbuluar, keqpërdour ose kompromentuar.</p>	<p>EMAILI PrivacyProgramOffice@moneygram.com</p>
<p>Ndihmë e përgjithshme për agjentin</p> <p>Agjentët dhe punonjësit e tyre mund të kontaktojnë MoneyGram-in për të marrë ndihmë ose udhëzime në lidhje me tema të përgjithshme duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat për kthim fondesh konsumatorëve; • Mbështetje për pajisjet dhe teknologjinë; • Për të kërkuar trajnim për pajtueshmërinë ose sistemet; dhe • Për çfarëdolloj pyetjeje tjetër që nuk është mbuluar nga informacioni i kontaktit i dhënë më sipër. 	<p>TELEFONI Shtetet e Bashkuara 1-800-444-3010 në anglisht ose spanjisht</p> <p>SHËRBIMI "MË KONTAKTO" PËR AGJENTIN <i>Interneti</i> https://www.callmoneygram.com/moneygram</p> <p><i>Telefoni</i> +1 720 362 5024 (kjo telefonatë është falas)</p> <p>SHËRBIMI "MË KONTAKTO" POWERTRANSACT <i>Interneti</i> https://www.callmoneygram.com/PwT</p> <p><i>Telefoni</i> +1 720 362 5025 (kjo telefonatë është falas)</p> <p>NË INTERNET Plotësoni formularin në internet duke vizituar http://corporate.moneygram.com/compliance</p>